



REPUBLIKA E DREJTORËVE

Vendimarrjet që na varfëruan

RAPORT MONITORIMI

Shtator 2026



AUTOR
Ilir Brasha

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al

PËRMBAJTJA

1	HYRJE	3
2	ADMINISTRATA MË E MADHE PUBLIKE	8
3	PENSIONET	12
4	PAGESA PËR LARGIM NGA PUNA	14
5	PAGESA ARBITRAZH NDËRKOMBËTAR	16
6	DËMI EKONOMIK	17
7	ARSYET PSE PROTESOHET SIPAS MONITOR	18
8	RREZIKU PËR TË QENË I VARFËR	19
9	PABARAZIA	21
10	PAGAT E ULËTA	23
11	SA TAKSA MBI PAGËN PAGUAJNË SHQIPTARËT?	24
12	INDEKSI I KOSTOS SË JETESËS	26
13	RRITJA E ÇMIMEVE	27
14	INVESTIMET QË NUK NDODHËN	29
15	RAPORTE TË TJERA TË QËNDRESËS QYTETARE	31
🔍	GJETJET KRYESORE	32
✓	REKOMANDIME	35
📖	REFERENCA	37



1 HYRJE

“Shqipëria është një vend i bekuar nga natyra” është një shprehje që përsëritet shpesh dhe jo pa arsye. Në një territor relativisht të vogël, vendi ynë përmban një pasuri të jashtëzakonshme natyrore, nga bregdeti dhe zonat e mbrojtura, te burimet ujore, malet, pyjet dhe tokat bujqësore. Ky kombinim i jep Shqipërisë një potencial të konsiderueshëm për zhvillim ekonomik dhe social. Megjithatë, ndër vite, ky potencial nuk është shndërruar sa duhet në mirëqenie për qytetarët, ndërsa keqadministrimi, mungesa e vizionit afatgjatë dhe mënyra e menaxhimit të burimeve publike kanë penguar shfrytëzimin e tij të plotë.

Në vitin 2026, në Shqipëri nisi një protestë qytetare, e cila gradualisht u shndërrua në një lëvizje më të gjerë kundër mënyrës se si është qeverisur dhe administruar vendi. Në momentin e hartimit të këtij raporti, protesta ka kaluar tre muaj qëndrueshmëri dhe vijon të jetë aktive.

Pikënisja e saj ishte kundërshtimi i projekteve për ndërtimin e resorteve luksoze në zonat e Zvërnecit, Nartës dhe Sazanit, përfshirë territore me status të veçantë mbrojtjeje. Pikërisht nga mbrojtja e këtyre pasurive natyrore lindi ajo që sot njihet si “Revolucioni i Flamingove”.

Megjithatë, ajo që nisi si një reagim për mbrojtjen e natyrës, shumë shpejt u zgjerua përtej një çështjeje të vetme. Problematikat e ngritura nga qytetarët sollën në vëmendje çështje më të mëdha që lidhen me mënyrën e administrimit të pasurive publike, përdorimin e buxhetit, zhvillimin ekonomik, pabarazinë dhe cilësinë e qeverisjes. Në këtë mënyrë, protesta mori edhe dimensionin e një kundërshtimi më të gjerë ndaj modelit të qeverisjes dhe politikës që ka dominuar tranzicionin shqiptar gjatë 35 viteve të fundit.

Nga kjo pikënisje ndërtohet edhe ky raport. Përmes një sërë treguesish dhe të dhënash, synojmë të argumentojmë një tezë të thjeshtë: Shqipërisë nuk i mungojnë burimet dhe as paratë, asaj i mungon administrimi efikas i tyre dhe shfrytëzimi i potencialit në interes të qytetarëve.

Raporti sjell në vëmendje indikatorë konkretë që tregojnë potencialin ekonomik dhe natyror të vendit, burimet financiare që qarkullojnë apo shpenzohen nga shteti dhe përballë tyre, rezultatet që marrin qytetarët.

Indikatori i parë i marrë në analizë është administrata publike, e cila është zgjeruar vazhdimisht gjatë viteve të fundit. Vetëm në periudhën 2020–2025, numri i punonjësve në administratën publike është rritur me 9,943 persona. Kjo rritje ndodh ndërkohë që popullsia e Shqipërisë është në rënie dhe një pjesë e konsiderueshme e shërbimeve publike tashmë ofrohen online.

Por çfarë punonjësish janë shtuar? Të dhënat tregojnë se ndryshimi më i madh lidhet me grup-profesionin “Ligjvënës, nëpunës të lartë dhe drejtues”. Në vitin 2025, administrata publike kishte 10,016 punonjës më shumë në këtë kategori krahasuar me vitin 2020. Pra, në 5 vite kemi shtuar mbi 10 mijë



punonjës në pozicione drejtuese. Ajo çfarë bie më shumë në sy është raporti drejtues me punonjës të tjerë, i cili ka rënë drastikisht nga viti në vit.

Kjo rritje ka ndryshuar ndjeshëm edhe raportin ndërmjet drejtuesve dhe pjesës tjetër të administratës. Në vitin 2020 kishte mesatarisht 1 drejtues për çdo 11.33 punonjës të tjerë, ndërsa në vitin 2025 ky raport ka zbritur në 1 drejtues për çdo 6.65 punonjës të tjerë. Pra, brenda pesë viteve, administrata publike ka jo vetëm më shumë punonjës, por edhe një peshë dukshëm më të madhe të kategorisë së drejtuesve dhe nëpunësve të lartë në raport me pjesën tjetër të saj.

Për të kuptuar se çfarë do të thotë kjo rritje për financat publike, është përlllogaritur kostoja vjetore e 10,016 ligjvënësve, nëpunësve të lartë dhe drejtuesve shtesë. Sipas përlllogaritjes, vetëm këta punonjës i kushtojnë buxhetit të shtetit rreth 19.83 miliardë lekë në vit (afërsisht 204.9 milionë euro).

Përmasat e kësaj shume kuptohen më qartë nëse e krahasojmë me financimin e pushtetit vendor. 19.83 miliardë lekë (afro 204.9 milionë euro) janë sa transfertat buxhetore që Qeveria Qendrore u shpërndan, të marra së bashku, 46 bashkive të vendit. Pra, kostoja e një viti për 10,016 ligjvënësit, nëpunësit e lartë dhe drejtuesit që i janë shtuar administratës që nga viti 2020 është e barabartë me transfertat buxhetore vjetore të 46 bashkive të Shqipërisë.

Aspekt tjetër shumë i rëndësishëm dhe problematik janë edhe pensionet e ulëta dhe fuqia e tyre blerëse. Për të shikuar sesa kanë ndryshuar pensionet nga viti në vit, është realizuar raporti i pensioneve kundrejt pagës mesatare në sektorin publik për vitet 2000-2025. Në vitin 2000, një pension mesatar pleqërie ishte sa 25% e pagës mesatare në sektorin publik, ndërkohë që në vitin 2025 ka arritur në vetëm 19%. Pra një pensionist mesatarisht ka humbur 6 pikë përqindje që nëse përkthehen në para, rezulton në vlerën 5,410 lekë (55.9 euro). Ndërkaq, një pension invaliditeti në vitin 2000 ishte sa 23% e pagës mesatare në sektorin publik, ndërkohë që në vitin 2025 është sa 19% e pagës mesatare në sektorin publik. Po ashtu pensioni familjar ka rënë nga raporti 13% e pagës mesatare në sektorin publik në 9% të saj. Si rrjedhojë e kësaj edhe fuqia blerëse e pensionistëve ka rënë vazhdimisht. Një pensionist që merr pension pleqërie është të paktën 5,410 lekë (55.9 euro) më i varfër sesa një pensionist në vitin 2000, ndërkohë që supozohet që të kishim përmirësim. Për më tepër edhe metodologjia e indeksimit të pensioneve ka ndryshuar, ku tanimë pensionet mund të indkesohen me muaj në të cilët niveli i inflacionit është më i ulët. Përkatesisht, kjo është gjetje e auditimit të KLSH që shprehet: “Ky nivel më i ulët i indeksimit rezulton si pasojë e ndryshimeve të bëra me VKM nr. 11, datë 11.01.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 131, datë 22.02.2017 të Këshillit të Ministrave, për përcaktimin e listës së mallrave të zgjedhura dhe metodën e llogaritjes së indeksit” që e zëvendësoi metodologjinë e mëparshme të përlllogaritjes vjetore, duke mundësuar përdorimin e muajve me inflacion më të ulët si referencë.”.



Problematikë tjetër e rëndësishme janë edhe pagesat që kryhen nga arka e shtetit për personat të cilët janë larguar padrejtësisht nga puna. Në total në vetëm 4 vite (2021-2025), janë ekzekutuar 4.47 miliard lekë (46.2 milionë euro) pagesa nga thesari i shtetit për largime të padrejta nga puna. Në vitin 2023 barra buxhetore për këto pagesa ishte afërsisht 870 milionë lekë (8.99 milionë euro), ndërkohë që në vitin 2024 u rrit në 1.16 miliard lekë (12 milionë euro) dhe në vitin 2025 arriti në 1.26 miliard lekë (13 milionë euro). Për të kuptuar më qartë përmasën e kësaj kostoje për qytetarët shqiptarë, 4.47 miliardë lekët (46.2 milionë euro) e paguara gjatë katër viteve për dëmshpërblimin e punonjësve të larguar padrejtësisht nga puna mund të krahasohen me Transferrat e Pakushtëzuara që Qeveria Qendrore u shpërndan bashkive.

Sipas buxhetit të vitit 2026, 4.47 miliardë lekë (46.2 milionë euro) janë afërsisht sa Transferrat e Pakushtëzuara që marrin së bashku rreth 17 bashki të vendit (16 bashki e gjysëm) për një vit të plotë.

Para të humbura nga taksat e qytetarëve shqiptarë janë edhe pagesat e bëra në arbitrazh ndërkombëtar. Përkatesisht 987 milion 137 lekë (10.2 milionë euro) nga xhepat e qytetarëve shqiptarë, për 4 vite, 2021-2025 kanë humbur duke u bërë pagesa për vendimarrje të gabuara nga institucionet shqiptare dhe duke shkuar deri në arbitrazh. Kjo shifër është e barabartë me transfertat e pakushtëzuara të 6 bashkive në vend për vitin 2026.

Problemet janë evidentuar edhe nga kontrollet dhe auditimet e kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, të cilët japin shifra mbi dëmin ekonomik (pra humbjet e drejtëpërdrejta) si dhe kostot financiare negative (humbjet për shkak të joeficiencës). Rezulton që Dëmi ekonomik në vitin 2024 është 142.7 milionë lekë (1.47 milionë euro), ku 121.7 milionë lekë (1.26 milionë euro) vjen nga mos mbledhja e të ardhurave dhe pjesa tjetër 21 milionë lekë (217 mijë euro) vjen nga realizimi i shpenzimeve jo në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi. Kur shikojmë efektet financiare negative, rezulton që KLSH ka konstatuar në vitin 2024 një efekt negativ në buxhetin e shtetit prej 10.38 miliard lekë (107.3 milionë euro), ku 8.49 miliard lekë (87.7 milionë euro) vijnë nga përdorimi dhe mbledhja jo efiçiente e të ardhurave, kurse pjesa tjetër prej 1.89 miliard lekë (19.5 milionë euro) vjen si pasojë e shpenzimeve jo efiçiente.

Aspekt tjetër shqetësues janë rezultatet e indikatorit që tregon përqindjen e popullsisë që janë risk për qenë të varfër dhe të privuar nga jeta sociale. Rezultatet tregojnë se në Shqipëri 40.5% e popullsisë janë në rrezik për të qenë të varfër, ndërkohë që në vendet e tjera të Europës kjo shifër është relativisht më e ulët. Mali i Zi është vendi i dytë me pjesën më të madhe të popullsisë në rrezik për të qenë të varfër, përkatësisht 31% e popullsisë malazeze. Në vend të tretë po prapë me diferencë të lartë me Shqipërinë është Turqia me 30.4% të popullsisë së saj në rrezik për të qenë të varfër. Më pas ndjekin Bullgaria me 30.3%, Rumania me 27.9%, Maqedonia e Veriut me 27.1%.

Diferenca midis Shqipërisë dhe vendeve të tjera të marra në krahasim është shqetësuese. Të dhënat tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e popullsisë



shqiptare, rreth dy në çdo pesë qytetarë, përballet me vështirësi ekonomike dhe është në rrezik varfërie apo përjashtimi social.

Megjithatë, një panoramë disi tjetër paraqitet kur analizohet pabarazia në shpërndarjen e të ardhurave. Indeksi S80/S20, i cili krahason të ardhurat e 20% të popullsisë me të ardhurat më të larta me ato të 20% të popullsisë me të ardhurat më të ulëta, për Shqipërinë në vitin 2024 rezulton 4.8. Kjo do të thotë se 20% më i pasur i popullsisë ka të ardhura rreth 4.9 herë më të larta se 20% më i varfër.

Pagat e ulëta janë një tjetër aspekt problematik i evidentuar. Sipas Numbeo, paga neto mesatare në Shqipëri rezulton 653 euro pas taksave, ndërkohë që në Bosnje & Hercegovinë 742 euro, në Serbi 843 euro, dhe në Mal të Zi 903 euro. Në gjithë Europën, Shqipëria ka një pagë pas taksave më të lartë vetëm se Ukraina (e cila është në gjendje lufte), Kosova (shteti i ri, duke konsoliduar institucionet), dhe Bjellorusia (shume hapa larg BE-së). Pra, paga mesatare në Shqipëri është relativisht e ulët dhe jemi larg edhe vendeve të tjera të Ballkanit, pa u krahasuar me vendet e tjera që aspirojmë që të arrijmë.

Për të kuptuar më mirë nivelin e pagave dhe barrën që lidhet me to, në këtë raport është përllogaritur edhe norma reale e detyrimeve mbi pagën, duke përfshirë Tatimin mbi të Ardhurat Personale (TAP), sigurimet shoqërore dhe sigurimet shëndetësore, si nga ana e punëmarrësit ashtu edhe nga ajo e punëdhënësit.

Analiza tregon se raporti ndërmjet pagës që punonjësi merr realisht në xhep dhe detyrimeve që paguhen për të ndryshon ndjeshëm sipas nivelit të pagës. E paraqitur grafikisht, kjo marrëdhënie krijon një kurbë në formën e një U-je të përmbysur, barra rritet gradualisht deri në një nivel të caktuar page dhe më pas fillon të ulet në terma relativë.

Në nivelin e pagës minimale, një punonjës merr rreth 44,400 lekë neto (459 euro), ndërsa për këtë pagë paguhen rreth 13,900 lekë (144 euro) të tjera në formën e tatimeve dhe kontributeve. Kjo do të thotë se detyrimet përbëjnë rreth 31.4% të shumës që punonjësi merr neto, ndërsa kostoja totale e punës arrin në rreth 58,300 lekë (603 euro).

Me rritjen e pagës, rritet edhe pesha e këtyre detyrimeve në raport me pagën neto. Ajo arrin pikën maksimale në nivelin e një page prej rreth 145,300 lekësh neto (1,500 euro), ku tatimet dhe kontributet arrijnë në rreth 49.8% të pagës neto. Pas këtij niveli, pesha relative e detyrimeve fillon të bjerë, duke arritur gradualisht në rreth 37% të pagës neto për pagat më të larta. Kjo lidhet ndër të tjera me ekzistencën e pagës maksimale mbi të cilën përllogariten kontributet shoqërore.

Një panoramë më konkrete jep paga mesatare. Në tremujorin e parë të vitit 2026, paga mesatare bruto për një të punësuar ishte 90,119 lekë (931 euro), e cila



përkthehet në rreth 72,210 lekë (746 euro) neto që punonjësi merr realisht në llogarinë e tij.

Megjithatë, 72,210 lekë (746 euro) nuk janë kostoja reale e këtij punonjësi. Kur përfshihen të gjitha tatimet dhe kontributet që lidhen me pagën, llogariten edhe rreth 32,958 lekë (341 euro) detyrime, ose sa 45.6% e pagës neto. Si rezultat, për një punonjës që merr në xhep 72,210 lekë (746 euro), kostoja totale arrin në rreth 105,168 lekë (1,087 euro) në muaj.

Pra, për çdo 100 lekë (1 euro) që një punonjës me pagë mesatare merr neto, rreth 46 lekë (46 cent) të tjera paguhet në formën e tatimeve dhe kontributeve të lidhura me pagën.

Taksat e larta nuk ndalen vetëm tek paga por edhe tek produktet e konsumit, ku një nga më kryesorët është nafta. Nafta në Shqipëri është me e shtrenjta në rajon dhe e 5-ta më e shtrenjtë në Europë. Çmimi i lartë i naftës në Shqipëri vjen tërësisht për shkak të kostove të larta, ku rezultojnë që 52.4% e total çmimit të saj janë vetëm taksa, të cilat shkojnë në Buxhetin e Shtetit.

Edhe pse pagat janë të ulëta, taksat e larta, kostot e jetesës në Shqipëri janë ndër më të lartat në rajon. Sipas indeksit të kostos së jetesës së publikuar nga NUMBEO, rezultojnë që Shqipëria ka nivel më të lartë të kostove të jetesës krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Përkatësisht, kostot e jetesës në Shqipëri janë sa 48.9% e kostove në New York, ndërkohë që në vendet e tjera të rajonit janë më të ulëta, përjashtuar Kroacinë.

Rritja e kostove të jetesës lidhet padyshim edhe me rritjen e çmimeve. Kur analizojmë inflacionin e përgjithshëm për gjashtë vitet e fundit, rezultatet tregojnë një rritje të moderuar të çmimeve, por kur shikojmë rritjen e çmimeve për produktet kryesore të shportës, e kuptojmë rritjen e lartë të kostove të jetesës. Përkatësisht, produktet e bulmetit janë ato që janë rritur më shumë, ku kosi natyral është rritur me 63.7%, djathi i bardhë me 74.2% etj. Po ashtu mishi është rritur shumë, mishi i qingjit apo kecit janë rritur me 64.3%, mishi i viçit me 51.8%. Mielli ka pësuar rritje me 27.5%, buka me 27.8%, Orizi me 24.9%, makaronat me 22.7%. Edhe fruta-perimet kanë shënuar rritje të ndjeshme të çmimeve, ku rritjen më të lartë e kanë shënuar specat me 66.9%. Pra, pavarësisht se inflacioni i përgjithshëm ka qenë ndër vite në vlera të moderuara, produktet kryesore të shportës janë rritur relativisht shumë.

Sikur të mos mjaftonin këto, rezultojnë se Buxheti i Shtetit nuk shpërndahet proporcionalisht siç duhet. Ndërkohë që shpenzimet korrente përgjithësisht realizohen në nivelin e planifikuar në Buxhetin fillestar, situata paraqitet ndryshe për investimet publike, të cilat kanë një normë të konsiderueshme mosrealizimi.

Për vitin 2025, 16% e investimeve të parashikuara në Buxhetin fillestar nuk u realizuan, çka do të thotë se u realizua vetëm 84% e planit.



Problematika bëhet edhe më e qartë në nivel projektsh. Nga një analizë e kryer në 7 ministri për vitin 2024, rezulton se 275 projekte investimi të parashikuara në buxhet nuk kishin nisur të zbatoheshin. Vlera e përgjithshme e këtyre projekteve të planifikuara, por të paekzekutuara, arrinte në rreth 33.7 miliardë lekë.

Shpesh thuhet që para nuk ka në Buxhetin e Shtetit, ndërkohë që në këtë raport tregohet që paratë nuk mungojnë, por shkojnë në vendin e gabuar, kjo e vërtetuar nëpërmjet auditimeve të KLSH, që ka matur dëmin ekonomik dhe efektet financiare negative, si dhe nëpërmjet pagesave të larta që janë kryer për largime të padrejta nga puna, nga pagesat e kryera për arbitrazh ndërkombëtar. Gjithashtu edhe mos-realizimi prej 16% të investimeve tregon një nivel jo të mirë përdorimi të parave publike, të cilat nuk përdoren për investime të cilat kanë ndikim pozitiv afatgjatë në jetën e qytetarëve shqiptarë. Pagat ndër më të ulëtat në Europë, pensionet e ulëta që po vazhdojnë që të humbin fuqinë e tyre blerëse, taksat ndër më të lartat, kostot e jetesës ndër më të lartat në rajon, inflacioni për produktet e konsumit të përditshëm relativisht i lartë kanë bërë që 40.5% e popullsisë të jetë në risk për të qenë e varfër. Këto dhe shumë arsye të tjera janë Shqipëria që nuk duan shqiptarët ekonomikisht, por e duan një Shqipëri që shfrytëzon në mënyrë të drejtë potencialin e saj të pamasë.

2 ADMINISTRATA MË E MADHE PUBLIKE

Administrata publike ka vijuar të zgjerohet, pavarësisht se gjithnjë e më shumë shërbime publike ofrohen online. Kur shikojmë të punësuarit në sektorin publik sipas grupprofesioneve, shikohen diferenca të mëdha në numër punonjësish në vitin 2025 krahasuar me vitin 2020. Në vitin 2020 shënoheshin 175,443 punonjës në sektorin public, ndërkohë që në vitin 2025 kemi një rritje të tyre me afro 10 mijë punonjës (9,943), duke arritur në 185,086 punonjës.

Tabela 1. Numri i punonjësve në sektorin shtetëror total dhe me pozicion ligjvënës, nëpunës të lartë dhe drejtues, si dhe raporti ndaj punonjësve të tjerë, 2020-2025


Viti	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Të punësuar ne sektorin shtetëror	175,443	183,255	184,114	181,645	182,430	185,386
Ligjvënës, nëpunës të lartë dhe drejtues	14,228	16,948	18,585	19,076	20,532	24,244
Raporti nëpunës të lartë ndaj punonjës të tjerë	11.33	9.81	8.91	8.52	7.89	6.65

Burimi: INSTAT, përpunuar nga Autori



Por punonjësit nuk janë shtuar proporcionalisht sipas grup-profesioneve. Përkatesisht e gjithë shtesa ka ardhur si pasojë e rritjes së numrit të punonjësve me grup-profesion Ligjvënës, Nëpunës të lartë dhe drejtues. Numri i të punësuarve me këtë grup-profesion është 10,016 punonjës më shumë, në vetëm 5 vite. Ndërkohë kategoria e profesioneve teknike dhe specialistë është ulur me 2,783 punonjës. Po njësoj edhe kategoria e grup profesionit “Nëpunës të thjeshtë” është reduktuar me 2,840 veta.

Grafiku 1. Të punësuar në sektorin shtetëror sipas grup-profesioneve, 2020 vs 2025




Burimi: INSTAT, përpunuar nga autori

Analiza sipas grup-profesioneve tregon se rritja më e madhe është përqendruar te funksionarët e niveleve të larta dhe pozicionet drejtuese, duke rritur peshën e tyre në raport me pjesën tjetër të administratës.

Sipas të dhënave të marra nga INSTAT të punonjësve në sektorin publik sipas grup-profesioneve rezulton që në vitin 2020 një ligjvënës, nëpunës i lartë apo drejtues ishte në raport 1 me 11.33 punonjës të tjerë në administratën publike. Pra me fjalë të thjeshta kemi një zyrtarë të lartë për çdo 11.33 punonjës (mesatarisht). Të dhënat për vitin 2025 na tregojnë që ky raport është reduktuar. Tanimë kemi një punonjës në nivele drejtuese për 6.65 punonjës të tjerë. Pra administrata po shton vendet e punës për pozicionet drejtuese dhe nëpunës të nivelit të lartë.



Grafiku 2. Numri i punonjësve në sektorin shtetëror me pozicion ligjvënës, nëpunës të lartë dhe drejtues, si dhe raporti ndaj punonjësve të tjerë, 2020-2025



Burimi: INSTAT, përpunuar nga Autori

Kostoja e këtyre punonjësve në administratë, vetëm duke llogaritur numrin e shtuar të punonjësve dhe pagat e tyre (si kosto bashkë me sigurimet shoqërore dhe shëndetësore që paguan punëmarrësi, në këtë rast shteti), për 12 muaj të vitit rezulton të jetë 19.83 miliardë lekë vetëm për një vit.

Kjo kosto nëse e krahasojmë me transfertat që bën Qeveria Qëndrore drejt bashkive në vend, rezulton që do të mbulonte këto transfertat për plot 46 bashki në vend. Pra në vetëm një vit, kostoja buxhetore e shtuar për shkak të numrit të rritur të nivelit drejtues nga viti 2020 në vitin 2025 është aq sa është total buxheti i transferuar nga Buxheti Qëndror drejt 46 bashkive që është planifikuar në Buxhet 2026. Tabela me shifrat përkatëse dhe emrat e bashkive është dhënë më poshtë.

Tabela 2. Kostoja e punonjësve në grup-profesionin “Ligjvënës, nëpunës të lartë dhe drejtues” të shtuar në 5 vite (2020-2025) vs transfertat e Qeverisë Shqiptare tek bashkitë 2026, në mijë lekë

Bashkia	Transferta Buxhetore (Buxhet Fillestar 2026)	Total Shpenzim e për 1 vit për punonjësit e shtuar me funksione të larta
Pustec	124,480	
Libohovë	133,678	
Konispol	181,976	
Këlcyrë	210,772	
Delvinë	215,572	
Dropull	226,266	
Poliçan	279,180	
Fushë Arrëz	290,596	
Tepelenë	306,487	
Memaliaj	308,091	



Bashkia	Transferta Buxhetore (Buxhet Fillestar 2026)	Total Shpenzime për 1 vit për punonjësit e shtuar me funksione të larta
Finiq	320,064	
Himarë	327,097	
Roskovec	330,468	
Belsh	335,671	
Përmet	343,916	
Klos	350,902	
Pukë	363,230	
Kolonjë	381,729	
Rrogozhinë	384,224	
Has	388,239	
Peqin	391,701	
Shijak	396,250	
Patos	405,207	
Dimal	408,318	
Skrapar	408,652	
Vorë	415,341	
Selenicë	415,729	
Cërrik	435,207	
Përrenjas	470,769	
Mallakastër	491,043	
Sarandë	492,248	
Tropojë	502,621	
Kuçovë	517,957	
Devoll	535,477	
Divjakë	557,894	
Vau i Dejës	560,514	
Mat	588,241	
Mirditë	604,307	
Gramsh	605,711	
Bulqizë	661,506	
Kurbin	683,054	
Gjirokastër	688,237	
Librazhd	704,391	
Malësi e Madhe	710,351	
Kavajë	714,398	
Maliq	773,109	



Bashkia	Transferta Buxhetore (Buxhet Fillestar 2026)	Total Shpenzime për 1 vit për punonjësit e shtuar me funksione të larta
Total	19,940,869	19,831,635

Burimi: Ministria e Financave, INSTAT, përpunuar nga autori

3 PENSIONET

Një nga problematikat më të rëndësishme sociale ndër vite mbetet niveli i ulët i pensioneve, veçanërisht në kushtet kur numri i pensionistëve është i lartë në raport me numrin e të punësuarve që kontribuojnë në skemën e sigurimeve shoqërore.

Për të kuptuar se si ka ndryshuar pozita ekonomike e pensionistëve ndër vite, në këtë raport është krahasuar masa mesatare e pensionit me pagën mesatare në sektorin publik. Ky raport tregon nëse pensionet kanë ndjekur apo jo të njëjtin ritëm rritjeje me pagat.


Të dhënat tregojnë një përkeqësim të këtij raporti. Në vitin 2000, pensioni mesatar i pleqërisë ishte sa 25% e pagës mesatare në sektorin publik, ndërsa në vitin 2025 ai përbënte vetëm 19% të saj. Pra, në 25 vite, raporti ka rënë me 6 pikë përqindje.

E njëjta tendencë vërehet edhe për kategoritë e tjera të pensioneve. Pensioni i invaliditetit, i cili në vitin 2000 ishte sa 23% e pagës mesatare në sektorin publik, në vitin 2025 ka zbritur në 19%. Ndërsa pensioni familjar ka rënë nga 13% në vetëm 9% të pagës mesatare në sektorin publik.

Këto të dhëna tregojnë se pensionet nuk kanë ndjekur të njëjtin ritëm rritjeje me pagat në sektorin publik. Si rezultat, hendeku midis të ardhurave të pensionistëve dhe të ardhurave nga puna është zgjeruar.

Situata bëhet edhe më problematike kur merret në konsideratë inflacioni. Shporta e konsumit të pensionistëve ka një peshë të konsiderueshme të shpenzimeve për nevoja bazë, veçanërisht ushqime, duke bërë që rritja e çmimeve të këtyre produkteve të ndikojë drejtpërdrejt në standardin e tyre të jetesës. Pra, ndërsa pagat janë rritur me një ritëm më të shpejtë, pensionet kanë mbetur relativisht pas, duke dobësuar pozicionin ekonomik të pensionistëve në raport me pjesën tjetër të popullsisë.



Grafiku 3. Raporti i pensionit mesatar ndaj mesatares së pagës në sektorin publik, 2000-2025


Burimi: INSTAT, përpunuar nga autori, 2000-2025

Për të pasur një vlerë të përafërt sesa është humbja në para, vlerë monetare e pensionistëve nga mos-rritja e pensioneve proporcionalisht me pagën mesatare në sektorin publik, është ruajtur i njëjti raport i vitit 2000 për nivelin e pensioneve kundrejt pagës mesatare në sektorin publik dhe është gjetur për vitin 2025. Rezulton që nëse i njëjti raport do të ruhej pensioni mesatar i pleqërisë duhej të ishte 24,580 lekë, dhe jo 19,171 lekë sa është tani, pra 5,410 lekë më shumë (që pensionistët i kanë humbur në fuqi blerëse). Mesatarisht një person i cili merr pension invaliditeti ka humbur në fuqi blerëse 3,729 lekë vetëm nga ndryshimi i raportit ndaj pagës mesatare në sektorin publik. Masa e këtij pensioni duhej që të ishte 22,867 që të ruante të njëjtin raport ndaj pagës mesatare, ndërkohë që rezulton që të jetë 19,139 lekë.

Po njësoj një person i cili merr një pension familjar prej mesatarisht 8,921 lekë, ndërkohë që nëse do të ruante të njëjtin raport ndaj pagës mesatare në sektorin publik në vitin 2000, ai duhej që të merrte të paktën 13,466 lekë. Pra mesatarisht humbja është në masën e 4,545 lekë.



Grafiku 4. Pensioni mesatar në vitin 2025 dhe sa duhej të ishte nëse do mbahej i njëjti raport me pagën mesatare në sektorin publik në 2000



Burimi: INSTAT, përpunuar nga autori, 2025

Për më tepër, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka evidentuar në vitin 2024, se në rastin e indeksimit të përvitshëm që bëhet për pensionin, rezulton që si bazë indeksimi merret një nga muajt me nivelin më të ulët të inflacionit. Pikërisht kjo ka ndodhur në vitin 2024, ku indeksimi i pensioneve u bë bazuar në muajin gusht 2024, muaj në të cilin vlera e inflacionit ishte më e ulët sesa në muajt paraardhës. KLSH shprehet: “Ky nivel më i ulët i indeksimit rezulton si pasojë e ndryshimeve të bëra me VKM nr. 11, datë 11.01.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 131, datë 22.02.2017 të Këshillit të Ministrave, për përcaktimin e listës së mallrave të zgjedhura dhe metodën e llogaritjes së indeksit” që e zëvendësoi metodologjinë e mëparshme të përlogaritjes vjetore, duke mundësuar përdorimin e muajve me inflacion më të ulët si referencë.”. Pra tanimë, për indeksim mund të përdoren muaj të cilët nuk pasqyrojnë rritjen e çmimeve të shportës së pensionistëve, gjë që bën të mundur që të thellohet akoma më tej diferenca midis pensionit dhe pagave. Ndërkohë, rritja e pensioneve sipas premtimeve të qeverisë ka filluar në mënyrë graduale në vitin 2026 për të arritur objektivin e rreth 40,000 lekëve në vitin 2030.

4

PAGESA PËR LARGIM NGA PUNA

Shteti shqiptar prej vitesh tanimë, paguan një pjesë nga Buxheti i Shtetit, detyrime të cilat shkojnë për largime të padrejta nga puna. Këto shpenzime nuk janë të pakta dhe tregojnë një problem të rëndësishëm në Shqipëri që ende vazhdon që të ekzistojë, ku shumë persona largohen nga puna në mënyrë të padrejtë dhe më pas kërkojnë të drejtën e tyre në gjykata, duke marrë kështu edhe dëmshpërblimet përkatëse. Pra, një pjesë e taksave tona shkon pikërisht për këto largime të padrejta nga puna. Fatura e këtyre largimeve nga puna vetëm në vitin 2025 rezulton 1.24 miliard lekë të




ekzekutuara në drejtim të personave të cilët kanë humbur punën e tyre në administratë padrejtësisht. Të dhënat për ekzekutimet janë përpunuar duke u bazuar në transaksionet ditore të thesarit nga Ministria e Financave për periudhën 2022-2025. Rezulton që nga viti 2023 kemi një rritje të pagesave të kryera nga thesari i shtetit për personat e larguar nga puna në mënyrë të padrejtë. Në vitin 2023 barra buxhetor për këto pagesa ishte afërsisht 870 milionë lekë, ndërkohë që në vitin 2024 u rrit në 1.16 miliard lekë dhe në vitin 2025 arriti në 1.26 miliard lekë. Në total në vetëm 4 vite, janë ekzekutuar pagesa nga thesari i shtetit për largime të padrejta nga puna në vlerën 4.47 miliard lekë.

Kjo shumë totale përkon me transfertat që bën Qeveria Shqiptare tek plot 17 bashki. Pra të ardhurat nga transfertat që marrin nga Buxheti i Shtetit 17 bashki në vend janë aq sa janë pagesat që bëhen për largimet e padrejta nga puna. Përkatesisht aq sa jep Buxheti i Shtetit për Bashkinë e Pustecit, Libohovës, Konispolit, Këlcyrës, Delvinës, Dropullit, Poliçanit, Fushë Arrësit, Tepelenës, Memaliajt, Finiqit, Himarës, Roskovecit, Belshit, Përmetit, Klosit dhe gjysmës së transfertave të Pukës, shkojnë për vendime të gjykatave si dëmshpërblime ndaj atyre që janë larguar padrejtësisht nga puna. Pra, nëse kjo shumë nuk do të ishte e humbur dhe nuk do të kishte shkuar për persona të cilët janë larguar padrejtësisht nga puna, buxheti i këtyre 17 bashkive do të ishte dyfishuar, nga dyfishimi i transfertave buxhetore drejt tyre.

Ndërkohë, nëse shikojmë pensionet dhe duke marrë vetëm këto para që janë humbje nga taksat e qytetarëve shqiptarë, pensionet mund të ishin rritur në vit me 1,600-1,700 lekë, për secilin nga pensionistët. Kjo vlerë është pothuajse e barabartë me indeksimin e përvitshëm të pensioneve.

Grafiku 5. Pagesa Thesari i shtetit për largime të padrejta nga puna, në milionë lekë



Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga autori, 2022-2025



Tabela 3. Total Transferta Buxhetore drejt Bashkive kundrejt Total shpenzime për largime të drejta nga puna, në mijë lekë

Bashkia	Total Transferta Qeveria 2026 (Buxheti fillestar)	Total Shpe nzime për largime të padrejta nga puna (2022-2025)
Pustec	124,480	
Libohovë	133,678	
Konispol	181,976	
Këlcyrë	210,772	
Delvinë	215,572	
Dropull	226,266	
Poliçan	279,180	
Fushë Arrëz	290,596	
Tepelenë	306,487	
Memaliaj	308,091	
Finiq	320,064	
Himarë	327,097	
Roskovec	330,468	
Belsh	335,671	
Përmet	343,916	
Klos	350,902	
Pukë	363,230	
Totali 17 Bashki	4,648,444	4,471,296


Burimi: Ministria e Financave, përpunimi i autorit

5 PAGESA ARBITRAZH NDËRKOMBËTAR

Përveç pagesave për largime nga puna, qytetarëve shqiptarë u shtohet edhe një kosto tjetër, ajo e vendimeve gjyqësore ndërkombëtare, pra arbitrazhit ndërkombëtar. Në vetëm 4 vite, nga taksat e shqiptarëve janë paguar rreth 1 miliard lekë në arbitrazh, saktësisht 987 milionë lekë. Të dhënat janë përpunuar duke u bazuar tek përshkrimet e faturave, në transkasionet e thesarit të publikuara nga Ministria e Financave. Pra, 987 miliard lekë nga xhepat e qytetarëve shqiptarë kanë humbur duke u bërë pagesa për vendimarrje të gabuara nga institucionet shqiptare dhe duke shkuar deri në arbitrazh.

Duke bërë të njëjtin krahasim me buxhetet e bashkive, rezulton që pagesat për arbitrazh kanë shkuar në 4 vite 2022-2025, pothuajse aq para sa për të financuar total transfertat buxhetore të 6 bashkive (Pustec, Libohovë, Konispol, Këlcyrë, Delvinë dhe Dropull).



Grafiku 6. Paga thesari i shtetit për arbitrazh ndërkombëtar, 2022-2025, në milionë lekë

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga autori

6 DËMI EKONOMIK

Një tjetër indikator i rëndësishëm për vlerësimin e menaxhimit të financave publike është dëmi ekonomik. Nivelet e larta të dëmit ekonomik tregojnë problematika në administrimin dhe përdorimin e parave të taksapaguesve.

Në këtë analizë dallohen dy kategori kryesore, dëmi ekonomik i drejtpërdrejtë, i cili përfaqëson humbje konkrete dhe të matshme të parave publike dhe efektet financiare negative, të cilat lidhen me keqmenaxhimin ose përdorimin joeficient të fondeve publike.

Pra, në të dyja rastet kemi një kosto për qytetarët: në rastin e parë, para publike të humbura drejtpërdrejt, ndërsa në të dytin, burime publike që nuk janë përdorur në mënyrën më eficiente dhe nuk kanë prodhuar vlerën e pritshme për qytetarët.

Nga kontrollet dhe auditimet e kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, rezultojnë që Dëmi ekonomik në vitin 2024 është 142.7 milionë lekë, ku 121.7 milionë lekë vjen nga mos mbledhja e të ardhurave dhe pjesa tjetër 21 milionë lekë vjen nga realizimi i shpenzimeve jo në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi.

Kur shikojmë efektet financiare negative, rezultojnë që KLSH ka konstatuar në vitin 2024 një efekt negativ në buxhetin e shtetit prej 10.38 miliard lekë, ku 8.49 miliard lekë vijnë nga përdorimi dhe mbledhja jo e eficientë e të ardhurave, kurse pjesa tjetër prej 1.89 miliard lekë vjen si pasojë e shpenzimeve jo eficientë.



Tabela 4. Dëmi ekonomik, 2023-2024, në mijë lekë

Zëri	2023	2024
Shpenzime për paga, shpërblime & sigurime shoqërore	3,069	1,186
Shpenzime të tjera	14,966	506
Zbatim punimesh / investime	86,338	19,337
Shpenzime	104,373	21,029
Të Ardhura nga aktiviteti doganor		73,534
Të Ardhura të tjera	16,935	48,166
Te ardhura	16,935	121,700
Total	121,309	142,729

Burimi: KLSH, 2023-2024

Tabela 5. Efekte financiare negative në Buxhetin e Shtetit, 2023-2024

Zëri	2023	2024
Shpenzime për Investime	1,450,777	301,089
Shpenzime operative	1,206,478	508,358
Shpenzime për paga, shpërblime & sigurime shoqërore	30,785	109,985
Shpenzime të tjera	651,235	966,826
Shpenzime	3,339,275	1,886,258
Të ardhura nga keqadministrimi i pasurisë shtetërore dhe marrëdhëniet kontraktuale me palët e treta	571,639	397,014
Të Ardhura nga aktiviteti doganor		565,974
Të Ardhura nga aktiviteti tatimot		370,180
Të Ardhura të tjera	142,906	5,881,658
Të ardhurat nga sektori i tatimeve në qeverisjen vendore	1,151,575	1,278,583
Te ardhura	1,866,120	8,493,409
Total	5,205,395	10,379,667

Burimi: KLSH, 2023-2024


7 ARSYET PSE PROTESOHET SIPAS MONITOR

Për të pasur një pasqyrë sa më të qartë të arsyeve pse po protestohet, Monitor realizoi një anketë përgjatë muajit korrik 2026 me 1,114 të intervistuar online. Anketa nuk është përfaqësuese, pasi është bërë pa monitorim kuotash, por gjithsesi jem një pasqyrim të realitetit se cilat janë disa nga arsyet kryesore. Pjesa më e madhe e mbështesin protestën dhe arsyeja kryesore pse i bënë ata që ta mbështesin protestën është korrupsioni i lartë në



vend, ndjekur nga keqkeqverisja dhe mungesa e llogaridhënies. E treta në rradhë vjen Mungesa e drejtësisë/mosndëshkimi i abuzimeve, ndjekur nga mbrojtja e interesit publik (mjedisi, arsimit, shëndetësia). Mungesa e perspektivës për të ardhmen renditet e pesta ndër arsytet, ndjekur nga varfëria dhe rritja e çmimeve në vend të gjashtë. Më poshtë në renditje vijon emigrimi i të rinjve dhe shpopullimi, pabarazia ekonomike dhe sociale, pagat e ulëta etj.

Figura. 1: Arsytet kryesore pse po protestohet, Korrik 2026 bazuar në të dhënat e Anketës së realizuar nga Monitor



Burimi: Monitor, 2026


8 RREZIKU PËR TË QENË I VARFËR

INSTAT publikon vit pas viti përqindjen e popullsisë që janë në rrezik varfërie dhe përjashtimi social. Të njëjtat të dhëna me rregullime të caktuara përdoren dhe publikohen edhe në EUROSTAT. Sipas metodologjisë të EUROSTAT, në risk për të qenë të varfër, konsiderohen ata persona të cilët ndodhen nën pragun e 60% të medianës kombëtare të të ardhurave të disponueshme të ekuivalentuara pas transfertave sociale.

Nëse shikojmë të dhënat, tregohet që pothuajse gjysma e popullsisë është në rrezik për të qenë e varfër. Sipas të dhënave të INSTAT në vitin 2020 në rrezik për të qenë të varfër rezultojnë 46.6% e popullsisë shqiptare. Gjatë viteve është shënuar përmirësim në këtë indikator duke arritur në vitin 2024 në nivelin 40.5%. Pra, rezultojnë që në vitin e fundit me të dhëna 40.5% e popullsisë ishte në rrezik për të qenë e varfër.



Grafiku 7. Përqindja e popullsisë së Shqipërisë në rrezik për të qenë e varfër, 2021-2025




Burimi: INSTAT, 2021-2024

Pavarësisht se indikator i rrezikut për të qenë i varfër duket sikur është në përmirësim, nëse shikojmë dhe krahasojmë të dhënat me vendet e tjera, në Shqipëri paraqitet një situatë alarmante. Për të sjellë këtë krahasim janë marrë të dhënat nga EUROSTAT për të gjitha vendet që publikon të dhëna. Të dhënat janë marrë për vitin 2024, për të pasur një krahasim sa më të gjerë midis vendeve, duke qenë se jo të gjitha vendet kanë të publikuar të dhënat për vitin 2025, ashtu si dhe Shqipëria.

Rezultatet tregojnë një aspekt alarmant për Shqipërinë. Në Shqipëri 40.5% e popullsisë janë në rrezik për të qenë të varfër, ndërkohë që në vendet e tjera të Europës kjo shifër është relativisht më e ulët. Mali i Zi është vendi i dytë me 31% të popullsisë malazeze në rrezik për të qenë të varfër, përkatësisht. Në vend të tretë po prapë me diferencë të lartë me Shqipërinë është Turqia me 30.4% të popullsisë së saj në rrezik për të qenë të varfër. Më pas ndjekin Bullgaria me 30.3%, Rumania me 27.9%, Maqedonia e Veriut me 27.1%, Greqia me 26.9%, Spanja me 25.8% e me rradhë. Më mirë në këtë tregues, pra më pak pjesë të popullsisë në rrezik varfërie ka Republika Çeke, me vetëm 11.3% të popullsisë në rrezik varfërie, Islanda me 11.7%, Sllovakia me 14.4% dhe Holanda me 14.4%.



Grafiku 8. Pjesa e popullsisë në rrezik për të qenë i varfër pas trasfertave sociale ne Europë, 2024



Burimi: Eurostat, 2024

9

PABARAZIA


Edhe pse qytetarët shqiptarë vazhdojnë që të ankohen se pabarazia po rritet dita-ditës, në fakt, të dhënat tregojnë një situatë të ndryshme. Një nga indekset më të përdorura për matjen e pabarazisë, S80/20 tregon që pabarazia në Shqipëri po ulet.

Indeksi S80/S20, i cili krahason të ardhurat e 20% të popullsisë me të ardhurat më të larta me ato të 20% të popullsisë me të ardhurat më të ulëta. Matjet e



vitit 2024, tregojnë se në Shqipëri ky raport është 4.8. Kjo do të thotë se 20% më i pasur i popullsisë ka të ardhura rreth 4.9 herë më të larta se 20% më i varfër.

Grafiku 9. Raporti S80/20, në Shqipëri, 2021-2024




Burimi: INSTAT

Edhe kur krahasohemi me vendet e tjera të rajonit, Shqipëria paraqitet në një situatë relativisht më të mirë në këtë aspekt, duke siguruar barazi më të madhe krahasuar me vendet e rajonit.

Shqipëria ka një indeks të ngjashëm me Kroacinë, por më të mirë sesa vendet e tjera të Ballkanit për të cilat ka të dhëna EUROSTAT. Krahasuar me mesataren e BE-së Shqipëria ka nevojë edhe pak për përmirësim, por përgjithësisht gjendet në një pozicion të favorshëm.

Grafiku 10. Raporti S80/20, në Shqipëri dhe vendet e ngjashme, 2023



Burimi: Eurostat, përpunuar nga autori




10 PAGAT E ULËTA

Niveli i pagave është një problem thelbesër në Shqipëri, edhe pse në vitet e fundit ka pasur tendenca për rritje të tyre, përsëri niveli mesatar i tyre mbetet relativisht i ulët, krahasur me nivelin e çmimive, të kostove të jetesës dhe bashkëqytetarëve që ndodhen në shtetet e tjera. Në një publikim të NUMBEO-s me vërtetimet që ka kryer përgjatë 12 muajve të fundit (Gusht 2025-Gusht 2026) lidhur me pagat mesatare pas pagesës së taksave sipas vendeve në të gjitha shtetet e botës, rezultoi që Shqipëria renditet ndër vendet e fundit në Europë me pagat më të ulëta. Përkatesisht në grafikun më poshtë janë marrë në shqyrtim të gjitha vendet europiane për të cilat ka publikuar të dhëna NUMBEO. Rezultatet tregojnë që një punonjës në Shqipëri merr mesatarisht një pagë neto, pra pagë pas heqjes së taksave, më të lartë në Europë vetëm se një qytetar në Ukrainë, Kosovë dhe Bjellorusi. Të gjitha vendet e tjera europiane kanë një pagë mesatare më të lartë mesatare pas taksave sesa Shqipëria, përpos Maqedonisë së Veriut që gjendet pothuajse në të njëjtin nivel me Shqipërinë. Paga neto mesatare në Shqipëri rezultoi 653 euro pas taksave, ndërkohë që në Bosnje & Hercegovinë 742 euro, në Serbi 843 euro, dhe në Mal të Zi 903 euro. Pra përsa i takon pagës mesatare ne jemi edhe mbrapa vendeve të tjera të rajonit.



Grafiku 11. Paga mujore mesatare neto, pas taksave, në Euro, për vendet e Europërs, Numbeo vrojtim i 12 muajve të fundit gusht 2025-gusht 2026



Burimi: Numbeo, 2025-2026

11 SA TAKSA MBI PAGËN PAGUAJNË SHQIPTARËT?

Niveli i ulët i pagave qoftë në sektorin publik ashtu edhe në privat është një problematikë që është përmendur vazhdimisht nga shqiptarët brenda vendit si dhe ata që kanë zgjedhur që të largohen. Sigurisht pagat janë të ulëta në krahasim me vendet e tjera, por edhe taksat janë relativisht të larta. Akoma nëse komunikim me njerëzit, një pjesë e tyre nuk kuptojnë dallimin midis pagës bruto dhe asaj neto, si dhe sa taksa paguan gjithsecili nga ata. Për t'ju përgjigjur kësaj pyetje, në këtë raport është gjetur përqindja reale e të



ardhurave të mbajtura në pagë nga shteti, ku përfshihet, TAP (Tatimi mbi të ardhurat personale), pagesat për sigurimet shoqërore dhe pagesat për sigurimet shëndetësore. Sipas ligjeve dhe vendimeve në fuqi, TAP ndryshon duke u rritur në përqindje me rritjen e pagës, përkatësisht nga 0% në pagën deri në 40,000 lekë bruto, në 6.5% për pagat nga 40,000-50,000 lekë për diferencën e pagës me 30,000, si dhe për pagat mbi 50,000 lekë kemi TAP 0% deri në 30,000 lekë, 13% për diferencën e pagës nga 30,000-200,000 leke dhe për pjesën e pagës mbi 200'000 lekë, TAP kalon në 23%.

Pjesë tjetër që mbahet mbi pagën janë edhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Sigurimet shëndetësore janë 3.4% e pagës bruto dhe 1.7% paguhen nga punëdhënësi dhe 1.7% nga punëmarrësi, pra në mënyrë të barabartë. Sigurimet shoqërore janë 24.5% e pagës dhe paguhen 15% nga punëdhënësi dhe pjesa tjetër 9.5% nga punëmarrësi. Sigurimet shoqërore paguhet deri në nivelin e pagës maksimale, e cila caktohet vit pas viti, përgjithësisht kur ndryshon paga minimale. Në vitin 2026, paga maksimale rezulton 186,416 lekë, pra që nënkupton që mbi këtë nivel page, sigurimet shoqërore nuk paguhen.

Duke pasur parasysh këto të dhëna janë kalkuluar pagesat që mban shteti nga punëdhënësi dhe punëmarrësi mbi pagë. Duke qenë se paga neto është ajo çfarë gjithsecili merr në fund, kalkulimet e pagesave ndaj shtetit janë bërë mbi këtë pagë. Për të pasur një pasqyrim edhe më të saktë është ndërtuar garfiku si më poshtë, ku në boshtin horizontal janë paraqitur niveli i pagave neto, kurse në boshtin vertikal është paraqitur sa përqind e pagës neto shkon në Buxhetin e Shtetit.

Siç shikohet qartë nga grafiku, deri në një pikë të caktuar të ardhurat mbi pagën që mban shteti apo institucionet e sigurimeve, vijnë në rritje në përqindje kundrejt pagës neto, ndërkohë që pas një pike të caktuar përqindja është më e ulët dhe kjo vjen si pasojë e pagave mbi pagën maksimale të miratur, mbi të cilën nuk paguhen sigurime shoqërore. Një person i cili ka një pagë bruto 50,000 lekë, ose thënë më qartë një pagë neto 44,400 lekë (që i merr realisht), paguan detyrime ndaj shtetit në masën 31.4%, ose e shprehur në vlerë 13,950 lekë. Pra punonjësi i cili ka një pagë bruto 50,000 lekë, merr në xhep 44,400 lekë dhe i paguan shtetit 13,950 lekë, nga të cilat 5,600 lekë i paguan ai, kurse pjesën tjetër e paguan institucioni ku punon (8,350 lekë).


Për tremujorin e parë 2026 paga mesatare bruto për një individ me pagë rezultonte 90,119 lekë, që shprehur në neto është 72,210 lekë, që realisht merr një individ me një pagë të tillë. Pra mesatarisht një individ që paguhet me pagë mesatare paguhet në xhep 72,210 lekë, kurse i mbahen si taksa dhe sigurime shoqërore edhe 45.6% të pagës neto, ose 32,958 lekë. Pra kostoja reale e një punonjësi që merr 72,210 lekë është 105,168 lekë.



Një person i cili merr 100,000 lekë neto rezulton që paguan 47,953 lekë në arkën e shtetit, ose pothuajse sa 48% të pagës së tij neto.

Përqindja maksimale e detyrimeve që paguhen në arkën e shtetit janë në pagën neto 145,300 lekë, ose rreth 186,500 lekë pagë bruto që përkon dhe me pagën maksimale. Përkatesisht në këtë nivel pagë paguhen pothuajse sa 50% e pagës neto detyrime (49.8% saktësisht), ose e shprehur në vlerë 72,392 lekë. Pas këtij niveli përqindja e detyrimeve që mbahet nga shteti vjen duke u ulur duke shkuar drejt normës 37% të pagës neto. Pra që të jetë e qartë, paga neto merret nga punëmarrësi dhe shtuar asaj paguhen edhe 37% si detyrime ndaj shtetit.

Grafiku 12. Pjesa reale e taksave që paguan një individ i punësuar në Shqipëri, sipas pagës neto që merr (% ndaj pagës neto që shkon si taksa apo sigurime shoqërore dhe shëndetësore), Gusht 2026



Burimi: Përpunim i autorit

12 INDEKSI I KOSTOS SË JETESËS

Kostoja e jetesës, e kombinuar me nivelin e ulët të pagave, është një nga problematikat kryesore ekonomike me të cilat përballen qytetarët shqiptarë.

Siç u evidentua më sipër, Shqipëria ka pagën mesatare neto pas taksave ndër më të ulëtat në rajon, duke lënë pas vetëm Kosovën. Megjithatë, situata përmbysset kur krahasohet kostoja e jetesës.


Sipas indeksit të koston së jetesës, ku si bazë krahasimi merret New York-u, Shqipëria rezulton vendi me koston më të lartë të jetesës ndër vendet e Ballkanit të marra në analizë. Kostoja e jetesës në Shqipëri përlllogaritet në 48.9% të nivelit të New York-ut, e ndjekur nga Serbia me 48.6%, Bosnjë-Hercegovina me 44.1%, Mali i Zi me 42.6%, Maqedonia e Veriut me 37.9% dhe Kosova me 31.1%.



Këto të dhëna evidentojnë një kontrast të fortë: Shqipëria ka ndër pagat neto më të ulëta në rajon, por njëkohësisht koston më të lartë të jetesës.

Në praktikë, kjo do të thotë se një qytetar shqiptar duhet të përballojë një nivel më të lartë shpenzimesh për jetesën sesa qytetarët e vendeve të tjera të rajonit të marra në krahasim, ndërkohë që të ardhurat e tij nga paga janë ndër më të ulëtat. Problemi, pra, nuk është vetëm sa fitojnë shqiptarët, por edhe sa mund të blejnë dhe çfarë standardi jetese mund të përballojnë me të ardhurat që marrin.

Grafiku 13. Indeksi i Kostos së Jetesës në vendet e Ballkanit, 2026 mes viti (% e kostos së jetesës në New York)



Burimi: Numbeo, 2025-2026

13 RRITJA E ÇMIMEVE

Një tjetër çështje me ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve shqiptarë është rritja e çmimeve, veçanërisht e produkteve të shportës bazë. Përtej nivelit të përgjithshëm të inflacionit, rëndësi të veçantë ka ecuria e çmimeve të produkteve dhe shërbimeve bazë, të cilat zënë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve të përditshme të familjeve shqiptare. Për të sjellë një krahasim sa më të përafërt me realitetin, INSTAT publikon çdo muaj nivelet e çmimeve për produktet kryesore të shportës së konsumit. Periudha e krahasimit është marrë Janar 2020, si periudhë para fillimit të ndikimit të Covid-19, si dhe shkurt 2026. Është marrë shkurt 2026, sepse janar 2026 kishte gabime në publikimin e të dhënave të INSTAT. Pra të dy periudhat janë të krahasueshme, sepse të dyja ndodhen në dimër, dhe pas vitit të ri. Nuk ka pasur pandemi në asnjë nga rastet që të ndikojë në rritjen e drejtpërdrejtë të çmimeve. Rezultatet tregojnë që çmimet janë rritur relativisht shumë në harkun kohor të 6 viteve.

Produktet e bulmetit janë ato që janë rritur më shumë, ku kosi natyral është rritur me 63.7%, djathi i bardhë me 74.2% etj. Po ashtu mishi është rritur



shumë, mishi i qingjit apo kecit janë rritur me 64.3%, mishi i viçit me 51.8%. Mielli ka pësuar rritje me 27.5%, buka me 27.8%, Orizi me 24.9%, makaronat me 22.7%. Edhe fruta-perimet kanë shënuar rritje të ndjeshme të çmimeve, ku rritjen më të lartë e kanë shënuar specat me 66.9%.

Pra, pavarësisht se inflacioni i përgjithshëm ka qenë ndër vite në vlera të moderuara, produktet kryesore të shportës janë rritur relativisht shumë.

Tabela 6. Niveli i çmimeve sipas produkteve kryesore të shportës së konsumit, 2020-2026, në lekë

Produkti	Njësia	Janar-2020	Shkurt-2026	Ndryshimi në %
		Cmimi mesatar	Cmimi mesatar	
Oriz	kg	149.2	186.4	24.9%
Miell	kg	89.1	113.6	27.5%
Buke	kg	107.7	137.6	27.8%
Makarona	kg	168.9	207.3	22.7%
Mish Vici	kg	797.1	1,210.0	51.8%
Mish Derri	kg	557.5	666.5	19.6%
Mish Qingji , Dashi E Keci	kg	792.0	1,301.2	64.3%
Mish Pule	kg	346.3	487.1	40.7%
Sallam	kg	570.7	729.3	27.8%
Kremvice	kg	576.2	772.7	34.1%
Proshute	kg	749.1	945.5	26.2%
Peshk I Fresket	kg	675.3	882.2	30.6%
Konserva Peshku	100 gr	120.6	175.0	45.1%
Qumesht I Fresket	liter	114.6	157.3	37.3%
Kos Natyral	kg	116.3	190.4	63.7%
Djathe I Bardhe	kg	530.8	924.4	74.2%
Djathe Kackavall	kg	735.2	1,241.0	68.8%
Gjize	kg	192.4	299.9	55.9%
Veze	kokerr	15.4	25.8	67.5%
Gjalp	kg	607.7	1,131.8	86.2%
Vaj Ulliri	liter	609.0	794.4	30.4%
Vaj Luledielli	liter	156.5	203.2	29.8%
Portokalle	kg	87.6	107.2	22.4%
Limona	kg	153.0	163.2	6.7%
Molle	kg	95.8	138.5	44.6%
Domate	kg	158.7	202.5	27.6%
Specat	kg	156.0	260.3	66.9%
Kastraveca	kg	209.5	237.5	13.4%



		Janar-2020	Shkurt-2026	
Ullinj	kg	260.1	297.1	14.2%
Fasule	kg	252.3	314.5	24.7%
Qepe E Thate	kg	67.6	78.0	15.4%
Patate	kg	58.4	77.9	33.4%
Sheqer	kg	72.4	91.0	25.7%
Mjalte	kg	1,104.2	1,410.7	27.8%
Kripe	kg	26.9	35.9	33.5%
Kafe E Bluar	100 gr	120.4	155.8	29.4%
Uje Mineral	liter	45.8	47.9	4.6%
Pije Jo Alkoolike Me Gaz	liter	96.8	114.2	18.0%
Lengje Frutash	liter	149.0	161.1	8.1%
Vere	0.75 liter	509.7	709.6	39.2%
Birre	0.5 liter	136.6	170.1	24.5%
Cigare	pakete	254.3	306.7	20.6%
Eurodizel	liter	171.4	173.3	1.1%
Benzine	liter	173.2	172.9	-0.2%
Lende Djegese Me Gaz	liter	62.4	56.7	-9.1%

Burimi: INSTAT, përpunuar nga autori

Për më tepër në një raport të mëparshëm të Qëndresa Qytetare mbi çmimet e naftës, rezulton që çmimi i naftës në Shqipëri është më i larti në rajon dhe të pestin më të lartë në Europë, pas Danimarkës, Zvicrës, Holandës dhe Finlandës.

Problemi kryesor me çmimin e naftës është tek niveli i lartë i taksave në një litër naftë. Përkatësisht sipas po të njëjtit studim, rezulton që 52.4% e total çmimit është në fakt taksa të cilat i mbledh shteti shqiptar. Pra, vetëm nga nafta në vitin 2025, arka e shtetit mbledhi afërsisht 73.6 miliard lekë, ose sa 9.76% e total të ardhurave të mbledhura në Buxhetin e Shtetit. Shqiptarët jo vetëm që marrin paga më të ulëta, por detyrohen që të kenë një kosto më të lartë jetesë, me rritje çmimesh të papërballueshme, dhe për më tepër, taksat e tyre përfundojnë në vendime gjykatash për arbitrazh ndërkombëtar apo për largime të padrejta nga puna.

14 INVESTIMET QË NUK NDODHËN

Një tjetër tregues i rëndësishëm i menaxhimit të financave publike është niveli i realizimit të investimeve të planifikuara. Për vitin 2025, në totalin e institucioneve të marra në analizë, rezulton se 16% e vlerës së investimeve të



parashikuara në buxhet nuk është realizuar brenda vitit, pra është realizuar vetëm 84% e planit.

Ndërkohë, një situatë e kundërt paraqitet për shpenzimet korrente, të cilat janë realizuar në masën 105%, duke tejkaluar nivelin e planifikuar në buxhet. Pra, ndërsa shpenzimet e përditshme jo vetëm realizohen, por tejkalojnë planin, investimet mbeten nën nivelin e parashikuar.

Në tabelën e mëposhtme tregohet realizimi i buxhetit sipas institucioneve buxhetore, dhe shikohet qartë se disa institucione kanë nivel relativisht të ulët të realizimit të investimeve të cilat kishin parashikuar për vitin 2025. Për shembull, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka realizuar gjatë vitit 2025 vetëm 75% të buxhetit të saj për investime, ndërkohë që 25% rezulton mos-realizim. Institucionet e tjera mund ti shikoni si mëposhtë:

Tabela 7. Realizimi i Plan Buxhetit fillestar sipas institucioneve, 2025, në mijë lekë

Ministria/Institucioni	Fakti 2025		Realizimi ne % me planin fillestar	
	Shpenzime Korente	Investime	Shpenzime Korente	Investime
Presidenca	281,416	33,490	83%	11%
Kuvendi	1,699,824	81,261	89%	59%
Kryeministria	669,242	2,911	82%	3%
Ministria e Ekonomise dhe Inovacionit	53,905,014	2,200,534	110%	86%
Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	11,172,277	3,662,790	115%	75%
Ministria e Infrastruktures dhe Energjise	7,908,580	63,550,759	118%	94%
Ministria e Financave	7,994,888	1,513,719	82%	112%
Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinise	55,177,744	4,255,468	98%	84%
Ministria e Ekonomise , Kultures dhe Inovacionit	5,999,645	1,514,937	137%	69%
Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale	78,105,328	3,795,292	102%	96%
Ministria e Drejtesise	13,120,985	1,809,835	102%	117%
Ministria per Evropën dhe Punet e Jashtme	2,927,661	598,995	82%	193%
Ministria e Brendshme	29,817,153	1,612,163	106%	58%
Ministria e Mbrojtjes	27,251,989	12,342,006	111%	44%
Sherbimi Informativ Shteteror	2,348,413	640,148	86%	640%
Drejtorja e Radio Televizionit	791,000	19,188	103%	19%
Drejtorja e Arkivit te Shtetit	335,911	126,000	99%	115%
Akademia e Shkencave	515,941	18,102	96%	181%
Kontrolli Larte i Shtetit	618,266	18,172	91%	121%
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	1,275,228	865,798	90%	56%



	Fakti 2025	Realizimi në % me planin fillestar		
Prokuroria e Pergjithshme	2,936,781	106,065	92%	82%
Keshilli i Larte Gjyqesor	4,364,266	367,207	83%	42%
Gjykata Kushtetuese	242,564	10,022	98%	72%
Agjensia Telegrafike Shqiptare	92,117	0	105%	0%
Keshilli i Larte i Prokurorise	199,328	138	96%	3%
Partite Politike	484,335	0	136%	-
Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar	1,058,785	292,719	63%	42%
Instituti Statistikes	843,353	137,231	93%	119%
Shkolla e Magjistratures	412,780	15,042	89%	57%
Fondi i Zhvillimit Shqiptar	0	24,012,184		107%
Qendra Kombetare Kinematografike	199,525	533	120%	53%
Institucionet e sistemit te drejtësisë	501,753	24,308	85%	45%
Avokati i Popullit	176,614	639	92%	16%
Komisioneri per Mbikqyrjen e Sherbimit Civil	89,260	0	93%	0%
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	3,163,512	164,492	822%	112%
Inspektoriati i Larte i Kontrollit dhe Deklarimit te Pasurive	244,626	45,397	100%	85%
Autoriteti Konkurences	114,819	6,353	100%	64%
Keshilli Kombetar i Kontabilitetit	13,156	92	75%	9%
Institucione te tjera Qeveritare	14,104,030	3,232,547	132%	70%
Mbeshtetje per Shoqerine Civile	128,481	316	95%	32%
Komisioneri për te Drejten e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	140,904	0	88%	0%
Komisioni i Prokurimit Publik	86,372	1,328	76%	22%
Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi	71,804	922	97%	92%
Instituti i Studimeve te Krimeve te Komunizmit	49,679	93	86%	9%
Autoriteti per Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit te Shtetit	151,938	7,542	96%	75%
Total	331,787,290	127,086,738	105%	84%

Burimi: Ministria e Financave

15

RAPORTE TË TJERA TË QËNDRESËS QYTETARE

Investime të parealizuar.

Në Shqipëri shpesh shikohen rrugë të papërfunduara, projekte të papërfunduara, si dhe projekte të tjera që ekzistojnë vetëm në letër. Për të shikuar këtë Qëndresa Qytetare ka analizuar projektet e parashikuara për 7 ministri kryesore dhe rezulton që për Ministrinë e Bujqësisë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjitikës, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë,



Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Mbrojtjes, përgjatë vitit 2024 nuk kanë realizuar e as filluar 275 projekt-investime të parashikuara në Planin Buxhetor, të cilat janë afërsisht në vlerën 33.706 miliard lekë.

Produktiviteti i ulët në ekonomi

Produktiviteti i punonjësve në Shqipëri është më ulët në rajon dhe Europë. Sipas vlerësimeve të ILO për vitin 2025 rezultonte që produktiviteti në Shqipëri është vetëm 19.5\$ në orë, që pothuajse 7\$ më pak sesa në Bosnje & Hercegovinë, 9.3\$ më pak sesa në Serbi, 14\$ më pak sesa në Maqedoninë e Veriut dhe 18\$ më pak sesa në Mal të Zi.

Tregu i punës dhe diplomat

Tregu i punës është një problem i vazhdueshëm në shoqërinë shqiptare, por në vitet e fundit thuhet shpesh që punë ka por nuk ka profesionistë. Në të vërtetë rezulton që punë ka, por nuk ka punë për të diplomuarit, por për ata të cilët nuk kanë një nivel të lartë arsimor të përfunduar. Në një studim të realizuar nga Qëndresa Qytetare rezulton që 53.5% e punëve aktive gjatë periudhës tetor-dhjetor 2024 në portalet kryesore të punësimit janë për persona të cilët nuk kanë një nivel të caktuar kualifikimi, ndërkohë që vetëm 25.2% e thirrjeve për punë kërkonin të paktën nivel universitar. Pra vetëm një në katër punë aktive ofrohet për persona të cilët kanë mbaruar universitetin. Për më tepër disa profesione si juridiku dhe shkencat sociale shfaqnin probleme me punësimin e tyre në profesion. Pra, shikohet qartë që as universitetet nuk janë të lidhura me tregun e punës, pra nevojat dhe kërkesat e tregut në Shqipëri.



GJETJET KRYESORE

Administrata publike

- 01** Në periudhën 2020–2025, administrata publike është zgjeruar ndjeshëm, duke shtuar rreth 9,943 punonjës, pavarësisht faktit që popullsia e vendit është në rënie dhe shumë shërbime janë dixhitalizuar.
- 02** Rritja më e madhe ka ndodhur në nivelet drejtuese, ku janë shtuar 10,016 drejtues, duke krijuar një strukturë të fryrë dhe joefikase.
- 03** Raporti midis drejtuesve dhe punonjësve është përkeqësuar ndjeshëm, duke kaluar nga 1 drejtues për 11.33 punonjës në vitin 2020, në 1 drejtues për çdo 6.65 punonjës në vitin 2025.



- 04** Kjo rritje ka sjellë një kosto shumë të lartë për buxhetin e shtetit, me rreth 19.83 miliard lekë në vit, që është e barabartë me transfertat e pakushtëzuara buxhetore për plot 46 bashki në vend.

Pensionet

- 05** Fuqia blerëse e pensioneve ka rënë ndjeshëm gjatë viteve, pasi raporti i pensionit të pleqërisë mesatar ndaj pagës mesatare në sektorin publik ka zbritur nga 25% në vitin 2000 në vetëm 19% në vitin 2025.
- 06** Kjo do të thotë se një pensionist sot është realisht më i varfër, me një humbje prej rreth 5,410 lekësh në muaj krahasuar me të kaluarën.
- 07** Për më tepër, ndryshimet në metodologjinë e indeksimit të pensioneve kanë bërë që rritjet të jenë më të ulëta, duke përdorur periudha me inflacion më të ulët si referencë.

Dëmet financiare nga shteti

- 08** Një pjesë e konsiderueshme e fondeve publike është përdorur për të paguar dëmshpërblime për largime të padrejta nga puna, që arrijnë në 4.47 miliard lekë për periudhën 2021–2025, kjo e barabartë me transfertat e pakushtëzuara për plot 17 bashki.
- 09** Gjithashtu, vendimmarrjet e gabuara kanë çuar në pagesa të konsiderueshme në arbitrazh ndërkombëtar, që arrijnë në rreth 987 milionë lekë për 4 vite (2021-2025), vlerë kjo e barazvlefshme me buxhetin e transfertave të pakushtëzuara të 6 bashkive.

Keqmenaxhimi financiar (KLSH)

- 10** Sipas auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, dëmi ekonomik për vitin 2024 arrin në 142.7 milionë lekë, që përfaqëson humbje direkte për buxhetin.
- 11** Ndërkohë, efektet financiare negative, që lidhen me joeficiencën në mbledhjen dhe përdorimin e të ardhurave, arrijnë në 10.38 miliard lekë.



Varfëria dhe pabarazia

- 12** Një pjesë shumë e madhe e popullsisë, rreth 40.5%, është në rrezik për të qenë e varfër ose në përjashtim social, një nivel shumë më i lartë se vendet e tjera të rajonit.
- 13** Edhe pse indeksi i pabarazisë S80/S20 duket relativisht i moderuar (4.9, pra 20% më i pasur ka të ardhura 4.9 herë më shumë se 20% më i varfër), kjo në fakt refiekton dobësimin e shtresës së mesme dhe jo një shpërndarje të drejtë të të ardhurave.

Pagat dhe taksat

- 14** Paga mesatare neto në Shqipëri është rreth 653 euro, duke e renditur vendin ndër më të ultët në rajon dhe në Europë.
- 15** Niveli i taksave mbi pagën është relativisht i lartë, duke arritur deri në 49.8% të pagës neto për disa nivele pagash dhe mesatarisht rreth 45.6% të pagës neto mesatare.
- 16** Kjo do të thotë që kostoja reale e një punonjësi është shumë më e lartë se paga që ai merr në dorë.

Kosto jetese dhe çmime

- 17** Shqipëria ka një nga kostot më të larta të jetesës në rajon, pavarësisht nivelit të ulët të pagave.
- 18** Çmimi i naftës është ndër më të lartët në Europë, ku mbi gjysmën e çmimit (52.4%) e përbëjnë taksat.
- 19** Produktet bazë ushqimore kanë pësuar rritje të ndjeshme të çmimeve në 6 vitet e fundit, përkatësisht, produktet e bulmetit janë ato që janë rritur më shumë, ku kosi natyral është rritur me 63.7%, djathi i bardhë me 74.2% etj. Po ashtu mishi është rritur shumë, mishi i qingjit apo kecit janë rritur me 64.3%, mishi i viçit me 51.8%. Mielli ka pësuar rritje me 27.5%, buka me 27.8%, Orizi me 24.9%, makaronat me 22.7%. Edhe fruta-perimet kanë shënuar rritje të ndjeshme të çmimeve, ku rritjen më të lartë e kanë shënuar specat me 66.9%.



Investimet publike

- 20** Një pjesë e konsiderueshme e investimeve publike nuk realizohet sipas planit, ku në vitin 2025 rreth 16% e tyre rezultojnë të porealizuara.
- 21** Gjithashtu, janë identifikuar 275 projekte investimi që nuk kanë filluar ose nuk janë ekzekutuar, me një vlerë totale prej rreth 33.7 miliard lekësh për vitin 2024.

Konkluzione

- 22** Problemi kryesor i ekonomisë shqiptare nuk është mungesa e fondeve, por mënyra joefikase dhe e gabuar e përdorimit të tyre.
- 23** Si pasojë, vendi përballlet me paga të ulëta, pensione të dobëta, taksa të larta dhe kosto të lartë jetese.
- 24** Këta faktorë kanë çuar në një situatë ku 40.5% e popullsisë është në rrezik varfërie, duke nxitur pakënaqësi të madhe sociale dhe protesta.



REKOMANDIME

- 1 Reformë në Administratën Publike** — Të ndërmerret një auditim i plotë funksional i administratës, me qëllim identifikimin e pozicioneve të panevojshme dhe reduktimin e niveleve të tepërta drejtuese, duke rikthyer një raport më të balancuar midis drejtuesve dhe stafit. Të vendoset sistem meritokracie dhe të shfrytëzohet dixhitalizimi i shërbimeve si mundësi për të ulur kostot e administratës.
- 2 Reforma në sistemin e pensioneve** — Të ndërmerren masa për indeksimin e plotë të infacionit dhe të vazhdojë që të ndiqet politika e rritjes së pensioneve në 40,000 lekë, sipas premtimit të dhënë. Kjo do bëjë të mundur që të rikuperohet raporti ndaj pagës mesatare në sektorin publik dhe të rikuperohet fuqia blerëse e pensionistëve.



3 Reforma në sistemin e pagave — Të ndërmerren reforma që fuqizojnë shtresën më të varfër dhe atë të mesme, duke i kaluar ata nga stadi i riskut të varfërisë. Ulja e barrave të taksave, do të nxiste bizenset të formalizoheshin dhe gjithashtu barra më e ulët do bënte të mundur që të kishte rritje më të dukshme të pagave qoftë në administratë, qoftë në sektorin privat.

4 Ulja e dëmeve financiare dhe abuzimeve — Të krijohet një mekanizëm për ndëshkimin e fajtorëve/vendimarrësve publik të cilët shkaktojnë dëme financiare për buxhetin e shtetit, siç janë rasti i vendimeve të arbitrazhit apo vendimeve të padrejta për largimin nga puna.

5 Ulja e kostos së jetesës — Të rishikohet niveli i taksave, sidomos i taksave mbi karburantin, në mënyrë që të ulë kostot e naftës dhe të transportit, duke pasur një ndikim të drejtëpërdrejtë edhe në produktet e tjera të konsumit të përditshëm. Gjithashtu të ketë një monitorim të shtuar të rritjes së porsyeshme të produkteve kryesore të shportës.

6 Menaxhimi më i mirë i investimeve publike — Prioritizim i investimeve publike të cilat kanë ndikim afatgjatë në përmirësimin e jetesës së qytetarëve. Të përmirësohet planifikimi i saktë i tyre dhe të ketë angazhim të qartë për nisjen dhe përfundimin e tyre sipas afateve përkatëse.



REFERENCA

Ministria e Financave – Thesari i Shtetit: <https://financa.gov.al/pagesa-te-kryera-nga-drejtoria-e-per-gjithshme-e-thesarit/>

Ministria e Financave – Buxheti: <https://financa.gov.al/ligji-i-buxhetit-fillestar-2026/>

INSTAT - Pagat vjetore: https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START___PKP_PTV/PKP1319/

INSTAT - Pagat tremujore: https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START_PKP_PTM/PTM011/

INSTAT - Pensionet: https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START_SS/SS0008/

INSTAT - Lista e çmimeve: <https://www.instat.gov.al/sq/statistika/lista-e-cmimeve/>

KLSH – Raporti i Buxhetit: <https://klsh.org.al/raporti-buxheti/>

EUROSTAT: https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ilc_pecs01_custom_22497578/default/table

NUMBEO: <https://www.numbeo.com/cost-of-living/>

EUROSTAT: https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ilc_di11/default/table?lang=en



INSTAT: https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START_TP_AD_ADY/ADY134/

Qëndresa Qytetare: <https://qeverisja.qq.com.al/wp-content/uploads/2026/01/full.pdf>

<https://qeverisja.qq.com.al/wp-content/uploads/2025/07/Raport-X-Ilir-Brasha-Produktiviteti.pdf>

<https://qeverisja.qq.com.al/wp-content/uploads/2025/01/Puna.pdf>

<https://qeverisja.qq.com.al/ëp-content/uploads/2026/05/Raporti.pdf>

Monitor: <https://monitor.al/anketa-e-monitor-nga-kapja-e-shtetit-te-korrupsioni-arsyet-pse-po-protestohet/>

Drejtorja e Tatimeve: <https://www.tatime.gov.al/c/4/96/108/tatimi-mbi-te-ardhurat-personale>



QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al